

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**KOMUNËN DROPULL I SIPËRM (NJËSI ADMINISTRATIVE E BASHKISË**  
**DROPULL)**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën e Dropull i Sipërm, njësi administrative e bashkisë Dropull**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri më 31.03.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 94, datë 16.07.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 365/7, datë 16.07.2015, i ka rekomanduar z. Ahilea Deçka, Kryetar i bashkisë Dropull i Sipërm, ku përfshihet njësi administrative Dropull i Sipërm, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Ndërtimi i ujësjellësit Jorgucat me pus shpimi të Komunës” Jorgucat, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultoi se materiali i gërmuar nuk ishte material shkëmbor por material shkëmbi i copëtuar deri në tokë të shkrifët, ndërkohë që ky zë proces pune është situacionuar nën zërin “Gërmim shkëmbi i fortë me çekiç me ekskavator me zinxhir”. Në këtë rast nuk është reflektuar ndryshimi i këtij formacioni tokësor. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (*për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm*) të merren masa për përcaktimin e saktë të këtij formacioni tokësor që rezultoi i gërmuar si dhe për të gjitha piketat e tjera në vazhdim në të cilat do të kryhen procese gërmimi. Analizat të kryhen nga laboratorë gjeo-teknikë të certifikuar dhe të njohur nga Ministria e linjës. Për çdo rast dhe çdo volum pune, të përcaktohet zëri konkret me të cilin kryhet procesi i punës si dhe vlera përkatëse sipas manualit teknik të çmimeve në fuqi ose sipas ofertave të tregut, duke marrë gjithmonë ofertën më të mirë midis tyre. Ndryshimet të reflektohen në situacionet në vazhdim dhe në atë përfundimtar.

*Në vazhdimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga Zyra e Taksave dhe Tarifave, nuk është arkëtuar detyrimi për taksën e kalimit të pronësisë për të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Sistemin e taksave vendore”.

**Rekomandimi:** Nga ana e Bashkisë Dropull (*për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm*), të merren masa të njoftojë zyrtarisht ZVRPP Gjirokastër mbi rekomandimin e lënë nga auditimi i KLSH-së për zbatimin e nenit 24, të ligjit 6932, datë 30.06.2006, i cili detyron atë ekskluzivisht për arkëtimin e taksës së kalimit të pronësisë për çdo pasuri të paluajtshme dhe në funksion të agjentit tatimor të kalojë në të ardhurat e bashkisë kuotën e përcaktuar sipas ligjit.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Janë hapur dosje individuale për secilin subjekt, por mungon inventari për përmbajtjen e materialeve në dosje dhe numri i fletëve. Dosjet nuk janë azhurnuar dhe përditësuar dhe të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, pasi në disa prej tyre mungon njoftim detyrimi, njoftim vlerësimi tatimor dhe dokumenti i pagesës së detyrimit, (mandat arkëtimi), ndërsa në disa dosje mungojnë; deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, gent planet, apo planimetritë kjo për taksën e ndërtesave, etj.

**Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Dropull (*për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm*), të merren masa që për aktivitetin fiskal në vitin 2015, dosjet e subjekteve të plotësohen me dokumentet e nevojshme.:

*Në vazhdimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** DTTV Dropull i Sipërm nuk ka përlogaritur dhe kontabilizuar penalitetet e debitorëve për mos arkëtimin në afat të detyrimeve ndaj NJQV-së (*Trajtuar në pikën 7 të programit të auditimit, faqet 67-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi :** Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Dropull (*për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm*) të merren masa që për për detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2014 të llogariten, kontabilizohen dhe arkëtohen penalitetet ndaj subjekteve që veprojnë në juridiksionin e NJQV-së.

*Në vazhdimësi*

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga DTTV nuk është përfshirë në treguesit e planit dhe të arkëtimin në fakt taksa e fjetjes në hotel në masën 5 % për xhiron e realizuar nga hoteleria që operon në territorin e Komunës Dropull i Sipërm, por është arkëtuar si taksë fikse në masën 20,000 lekë në vit .

**Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Dropull (*për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm*) të merren masa që duke filluar nga viti 2015 të njoftojë subjektet e hotelerisë të paraqesin deklaratën e xhiros për fjetjet në hotel. Mbi këtë bazë të bëhet planifikimi i të ardhurave dhe të ndiqet arkëtimi i detyrimit në masën që parashikon ligji.

*Në vazhdimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimit i kryer rezulton se të gjitha llojet taksave në fund të tremujorit të parë të vitit 2015 janë në shumën debitore 970,377 lekë..

**Rekomandimi :** Zyra e Taksave në bashkëpunim me strukturat e tjera si Policia e komunës të marrë masa për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitore në zbatim të nenit 5, shkronja “ç” nën-pika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore.”

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** Komuna Dropull i Sipërm nuk ka iniciuar procesin e hartimit dhe miratimit të Instrumentit Vendor të Planifikimit (Plani i Përgjithshëm Vendor) , duke mos vepruar e përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara nga neni 92, pika 1/a e ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” i ndryshuar.

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (*për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm*) të marrë masa dhe të filloj procesin e hartimit dhe miratimit të Instrumentit Vendor të Planifikimit (Plani i Përgjithshëm Vendor) , duke përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara nga neni 92, pika 1/a e ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” i ndryshuar.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Dosjet e subjekteve të pajisura me leje zhvillimore kanë mangësi të theksuar të dokuemntacionit tekniko-ligjor duke mos plotësuar kërkesat e ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” i ndryshuar dhe VKM nr. 502, Datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores Uniformë të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar .

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (*për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm*) të marrë masa për plotësimin e të gjitha dosjeve me dokumentacionin tekniko-ligjor të përcaktuar në VKM nr. 502, Datë 13.07.2011 “Për miratimin e Rregullores Uniformë të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:** Komuna Dropull i Sipërm nuk ka vazhduar procedura sa përcaktuar në nenin 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit të njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, duke tejkaluar afatet kohore të përcaktuar në nenin 17 të ligjit duke mos përmbushur procedurat e përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (*për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm*) të marrë masa për hartimin dhe miratimin e listave përfundimtar të pronave të paluajtshme që do të transferohen në pronësi dhe përdorim të njësisë vendore në përmbushje të përcaktimeve ligjore të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit të njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

*Menjëherë*

**11. Gjetje nga auditimi:** Komuna Dropull i Sipërm ka kryer transaksione të shitjes të pronës publike në 2 raste, në 1 rast shitje të pasurisë kullotë dhe 1 rast shitje të pasurisë përrua në papajtueshmëri me nenin 3 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për Shitblerjen e trojeve”, kreun

III, nenet 9-20 të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar, me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullisor” i ndryshuar, me ligjin nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për Rezervat” i ndryshuar.

**Rekomandim:** -Nga ana e Bashkisë Dropull (për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm) të marrë masa për rishikimin e dokumenteve të kontratës së shitjes së pronës publike në rastet e mësipërme, duke bërë plotësim sipas nevojës, në përmbushje të përcaktimeve ligjore me nenin 3 të ligjit 7980, datë 27.7.1995 “Për Shitblerjen e trojeve”, kreun III, nenet 9-20 të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar, me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullisor” i ndryshuar, me ligjin nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për Rezervat” i ndryshuar.

*Menjëherë*

**12. Gjetje nga auditimi:** Komuna Dropull i Sipërm ka kryer transaksione të dhënies me qira të pronës publike në 3 raste, në 2 raste ka dhënë me qira pasuri kullotë dhe 1 rast ka dhënë me qira pasuri arë, në papajtueshmëri me nenin 15 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullisor” i ndryshuar dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm) të marrë masa për rishikimin e kontratave të dhënies me qira të pronës publike në përmbushje të përcaktimeve ligjore të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullisor” i ndryshuar dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

*Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, ana e Bashkisë Dropull (për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm) të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën 3,262,495 lekë, si më poshtë:*

**1. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Ndërtimi i ujësjellësit Jorgucat me pus shpimi të Komunës” Komuna Dropull i Sipërm, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **2,234,671 lekë pa T.V.SH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3.

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm) të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,234,671 lekë pa T.V.SH** nga BOE “M....” sh.p.k dhe “H.....” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 22.12.2014 me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit Jorgucat me pus shpimi të Komunës” Komuna Dropull i Sipërm, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

*Në vazhdimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Ndërtim i depove të ujit në fshatrat Llongo dhe Krioner” Komuna Dropull i Sipërm, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **536,337 lekë pa T.V.SH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe neni 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm) të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **536,337 lekë pa T.V.SH** nga OE “S.....” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2 prot., datë 10.06.2014 me objekt “Ndërtim i depove të ujit në fshatrat Llongo dhe Krioner” Komuna Dropull i Sipërm, vlerë kjo e cila

përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

#### *Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Ndërtimi i rrugës Kërre” Komuna Dropull i Sipërm, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **410,993 lekë pa T.V.SH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm) të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **410,993 lekë pa T.V.SH** nga OE “N...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4 prot., datë 30.05.2013 me objekt “Ndërtimi i rrugës Kërre” Komuna Dropull i Sipërm, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

#### *Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Depo e Ujit Zervat” Komuna Dropull i Sipërm, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **61,804 lekë pa T.V.SH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm) të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **61,804 lekë pa T.V.SH** nga BOE “A....” sh.p.k dhe “J.....” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3 prot., datë 03.04.2012 me objekt “Depo e Ujit Zervat” Komuna Dropull i Sipërm, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

#### *Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Depo e Ujit Zervat” Komuna Dropull i Sipërm, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projekt – preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si rrjedhojë e hartimit të këtij preventivi sipas jo sipas vendimit nr. 708 datë 12.10.2011 në vlerën **265,783 lekë me T.V.SH**, nga të cilat **116,965 lekë me T.V.SH** (265,783 –148,818), përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes me diferenca negative ndajë buxhetit të Komunës prej mos përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të këtyre fondeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, Kreu II i ligjit nr., 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 3, Kreu I të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, me pikat 2, 3 dhe 9 të Vendimit nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.08.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” si dhe me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm) të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **116,965 lekë me T.V.SH** nga ing. G.M nën cilësinë e hartuesit të projekt – preventivit të punimeve.

#### *Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** KVO në prokurimin publik me objekt “Gjelberim dhe mbeshetje pemetarie” ka skualifikuar ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim duke përdorur dy standarde gjatë vlerësimit të ofertave në kundërshtim me nenin 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si rrjedhojë autoriteti kontraktor ka

paguar më shumë në përzgjedhjen e ofertës fituese duke sjellë dëm ekonomik për NJQV-në në vlerën 18,690 lekë.

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Dropull (*për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm*) të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 18,690 lekë ndaj znj. L.Xh, znj. A. K dhe z. S.N në cilësinë e anëtarit të KVO, për skualifikimin në kundërshtim me nenin 53 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të OE ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim dhe duke përdorur dy standarde.

**Menjëherë**

#### **D. 1 MASA ADMINISTRATIVE**

Nga ana e Bashkisë Dropull (*për llogari të NJQV të përthithur Komuna Dropull i Sipërm*) të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë, për:**

**1.1 Ing. I.P gjobë në vlerën 100,000** nën cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **2,234,671 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në kontratën me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit Jorgucat me pus shpimi të Komunës” në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3 .

**1.2. Ing. G.M,** nën cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **536,337 lekë pa T.V.SH** si dhe për mangësi në dokumentacion, më konkretisht në kontratën me objekt “Ndërtim i depove të ujit në fshatrat Llongo dhe Krioner”

- Në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **61,804 lekë pa T.V.SH** si dhe për mangësi në dokumentacion, më konkretisht në kontratën me objekt “Depo e Ujit Zervat” Komuna Dropull i Sipërm

**1.3 Ing. A.C,** për shkeljet e konstatuara si më poshtë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 4.:

**Nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve:**

- Në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **410,993 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në kontratën me objekt “Ndërtimi i rrugës Kërre” Komuna Dropull i Sipërm në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

**Nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve:**

- Në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **536,337 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në kontratën me objekt “Ndërtim i depove të ujit në fshatrat Llongo dhe Krioner” Komuna Dropull i Sipërm

**1.4. Ing. Tomorr Spahiu,** për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

**Nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve:**

- Në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **410,993 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në kontratën me objekt “Ndërtimi i rrugës Kërre” Komuna Dropull i Sipërm .

#### **D. 2 MASA ADMINISTRATIV**

Nga auditimi i ushtruar në Komunën Dropull i Sipërm, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 7 pika 2, 3/a ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të

ndryshuar dhe Kreu X i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar:

**2.1** Të shqyrtojë dhe të marrë *masë disiplinore dhe Gjobë* ,ndaj anëtarëve të Komisioni Vlerësimit të Ofertave, *konkretisht:*

**1. znj. L.Xh**

**2. znj. A.K**

**3. z. S.N**

**4. z. K.Z**

**2.2.** Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, *i kërkojmë Titullarit të Autaritetit Kontraktor (Kryetarit të komunës Dropull i Sipërm)*, që në zbatim të pikës 2, të nenit 72 “Kundërvajtjet administrative”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 81 “Masat disiplinore”, Kreu XI “Sanksionet administrative dhe masat disiplinore”, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të shqyrtojë dhe të marrë masa disiplinore, nga *Vërejtje*” deri në *“Vërejtje me paralajmërim”* ndaj *anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, sipas përgjegjësive përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit, konkretisht:*

**1. z. P.B**

**2. znj. A.F**

**3. z. A.P**

**4. z. L.K**

**5. z. V.P**

Nga Bashkia Dropull (për llogari të ish komunës Dropull i Sipërm), ka kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Mirosh Bogdo, Xhovan Domi, Julian Adili dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**